



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 56 datë 7.11.2022

**“PËR NJË SHITESË NË VKB NR. 1, DT. 22.01.2016  
‘PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË  
SHKODËR’, TË NDRYSHUAR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar; neni 1 germa ‘c’ ligji nr.68/2017 ‘Për financat vendore’; ligji nr.9632, datë 30.10.2006 ‘Për sistemin e taksave vendore’ të ndryshuar; pika 4.1 e udhëzimit nr.8885, datë 07.11.2016 “Për kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik” të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës; VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifave vendore” të ndryshuar; Shkresë nr.72/1 prot, datë 02.03.2022 ‘Kthim përgjigje’ e Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë një shtesë në VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër” të ndryshuar :

“Tarifa për librin e udhëtimit”, Kapitulli III, paragrafi III.4.3 “Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, dhënien e lejeve për ushtrim aktiviteti”, pika 13.

“Libri i udhëtimit për shërbimet turistike/të rastit të udhëtarëve brenda vendit (nr. fletëve/nr. udhëtimeve 25)”, sipas tabelës nr. 23 “Tarifat e licensimit të veprimtarive të transportit”, bashkalidhur këtij projekt-vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015  
“Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**K R Y E T A R**



**Brisela KADIJA**

Sekretari i Këshillit Bashkiak



**Denis Lesha**

Miratuar me 27 vota  
Vota Pro 27  
Vota Kunder 1  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur me datë 10.11.2022